



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1.3 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 14 paragrafi 1.3, nenit 26 të Statutit të Odës së Infermierëve të Kosovës, Këshilli Drejtues me datën 28.09.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për kriteret dhe procedurat e provimit profesional të Ri licencimit

1. Të drejtë për hyrje në provim kanë kandidatët të cilëve i ka skaduar afati i licencës në periudhë prej jo më shumë se 60 ditësh para skadimit të licencës, dhe të cilët nuk kanë arritur kriterin e paraparë të pikëve kredituese për ri licencim.
2. Të gjithë kandidatëve, të cilëve iu ka skaduar afati i licencës më shumë se 6 muaj nga data e skadimit, pa marrë parasysh sigurimin e pikëve kredituese, obligohen të ju nënshtrohen provimit profesional të ri licencimit.
3. Të gjithë kandidatët të cilët posedojnë 0-49 pikë kredituese, paguajnë taksën e plotë për provimin profesional të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me nr. Prot 637 të datës 04/05/2023.
4. Të gjithë kandidatët të cilët kanë arritur 50 apo më shumë pikë kredituese, por që nuk kanë arritur kriterin për ri licencim përmes edukimit të vazhdueshëm profesional, paguajnë taksën 50% nga taksa e përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues me nr. Prot 637 të datës 04/05/2023.
5. Kandidatët e pa punësuar Anëtarë të OIK, paguajnë taksën 50% nga taksa e përcaktuar me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues. Kandidatët duhet të dëshmojnë përmes vërtetimit nga Trusti Pensional i Kosovës.
6. Kandidatët të cilët arsyetojnë me dëshmi mjekësore mos arritjen e pikëve kredituese për ri licencim, me kërkesë të veçantë i drejtohen Këshillit Drejtues të OIK.
7. Kandidati i cili ka dështuar në një rënë nga lëndët e Provimit Profesional të Ri licencimit lirohet nga kjo taksë për Ri provim në atë lëndë, ndërsa kandidati i cili ka dështuar në dy apo më shumë lëndë të Provimit Profesional të Ri licencimit obligohet të nënshtrohet të gjitha provimeve dhe të paguaj taksën e provimit.
8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i KD të OIK-ut
Bashkim Mehmeti



Kryetare e OIK-ut
Ma. Nexhmije Gori